



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1639/ 6 prot.,

Datë 02 /09/2025

V E N D I M
Nr. 1168 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02 /09/2025 shqyrtoi ankesën me

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Bajro Bros” shpk në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-48924-05-26-2025, me objekt “Blerje rroba pune”, me fond limit 2,465,000.00 Lekë pa TVSH zhvilluar me datë 09-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujesjëllës Kanalizime Vlorë Sh.A

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Bajro Bros” shpk në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-48924-05-26-2025, me objekt “Blerje rroba pune”, me fond limit 2,465,000.00 Lekë pa TVSH zhvilluar me datë 09-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujesjëllës Kanalizime Vlorë Sh.A.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujesjëllës Kanalizime Vlorë Sh.A.
Adresa: Lagja “Kushtrimi”, rruga “Arkobaleno”, Vlorë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Bajro Bros” Shpk, me Nipt, M113130290, dhe adresë: *Rr. Ndre Mjeda, Kompleksi rezidencial “Magnet”, Pallati Lura, njesi sherbimi nr.1017Tiranë.*

Operatori ekonomik “Biotek” shpk, me Nipt L82203011N, dhe adresë: *Lagjja Dëshmorët, 1176, 1-5, Nr pasurie 14/63 +1/11, vol 2, fq 179, ZK8603.*

Persona të interesuar: Operatori ekonomik “Bajro Bros” Shpk me Nipt, M11313029O, dhe adresë: *Rr. Ndre Mjeda, Kompleksi rezidencial “Magnet”, Pallati Lura, njesi sherbimi nr.1017Tiranë.*

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27-05-2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, “me me Nr. REF-48924-05-26-2025, me objekt “Blerje rroba pune”, me fond limit 2,465,000.00 Lekë pa TVSH zhvilluar me datë 09-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujesjëllës Kanalizime Vlorë Sh.A.

II.2. Në datën 14.06.2025, autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku si më poshtë rezultojnë:

1. “Bajro Bross ” sh.p.k.	1 848 750	lekë Skualifikuar
2. “Biotek ” sh.p.k.	2.277.500	lekë Kualifikuar
3. “Gentjan Sadiku” PF	2,425,000	lekë Kualifikuar

II.4. Në datën 20.06.2025, nga verifikimet e kryera, konstatohet se autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin fituesit paraprak në SPE.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 24.06.2025 operatori ekonomik ankimues “Bajro Bross” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor me nr. ankimi A/2025/5462 dhe me nr. protokollin 1639 datë 24.06.2025 duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Në datën 24.06.2025, operatori ekonomik “Biotek ” sh.p.k, referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të prokurimit publik dhe autoritetit kontraktor me nr. ankimi A/2025/ 5470 dhe protokolluar me tonën me nr. 1650, datë 25.06.2025 ku kërkon lënien të skualifikuar të OE “Bajro Bross” SHPK.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit ankimi A/2025/5462 dhe me nr. protokollin 1639 datë 24.06.2025, ku u publikuan arsyet e skualifikimit të operatori ekonomik ankimues “Bajro Bross ” sh.p.k , Gjtitashtu KPP publikoi formularin me nr. ankimi A/2025/ 5470 dhe protokolluar me tonën me nr. 1650, datë 25.06.2025 me arsyet e pretendimeve të operatorit ekonomik “Biotek” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 1639/2 prot, datë 04.08.2025 Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesave të sipërcituara i është drejtuar autoritetit kontraktor ku i ka kërkuar kërkuar dhënien e informacionit mbi trajtimin e ankesave të operatoreve ekonomik “Biotek” SHPK. “Bajro Bross ” sh.p.k.

II.9. Me shkresën nr.1345/31 prot, datë 07.08.2025 protokolluar me tonën me nr.1639/3prot datë 11.08.2025, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Bajro Bross ” sh.p.k, ndërkohë për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Biotek” shpk autoriteti kontraktor nuk ka përcjellë dokumentacionin mbi trajtimin e ankesës me nr.1650/2025 datë 25.06.2025 për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se janë nuk paraqitur argumente nga subjekte të interesuara sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bross” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyen:

“*Mungo ekstrakti* ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

Me shkresën nr.1345/31 prot, datë 07.08.2025 protokolluar me tonën me nr.1639/3prot datë 11.08.2025, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Bajro Bross ” sh.p.k, ku ka vendosur , për pretendimin e paraqitur nga ky i fundit ,

VENDOSI :

Lidhur me arsyen sipas të cilës “mungon ekstrakti” qëndron dhe pranohet.

II.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës .1345/31 prot, datë 07.08.2025 protokolluar me tonën me nr.1639/3 prot datë 11.08.2025, rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bross” shpk dhe ka vendosur pranimin e pjeshëm të ankesës.

KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bross”shpk , për procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Bajro Bross”shpk.

III.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “Bajro Bross”shpk ardhur me ankesën nr. 1639/2025 në lidhje me pretendimin “ ...Nuk përputhet autorizimi me katalogun që keni depozituar, Katalogu mbn emrin Bajro Bross ”shpk , Komisioni i prokurimit publik vëren se,

III.2. 1. Autoriteti kontraktor në seksionin 2. “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.4.1 dhe 2.4.2 të dokumentave standarte të tenderit, ka parashikuar si në vijim,

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim :

2.4.1 Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DST , operatorët ekonomikë duhet të paraqesin katalogë teknike për të gjithë mallrat furnizues, ku të jepet qartë që mallrat janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.4.2 Furnizuesi duhet që të gjitha materialet t’i shoqërojë me çertifikatën e prodhuesit ose me autorizim /deklarate nga prodhuesi , që vërteton përputhjen me specifikimet teknike të kërkuara.

III.2.2 Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat*

e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.3 Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.2.4. Në nenin 36 , të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

a) *kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

b) *standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

c) *kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

ç) *të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

4. *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi*

ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III .2. 5.Në nenin 124 , të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” 1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi.2. Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor.

3. Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj.

4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit.


5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit.


6. Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse

ajo është në përputhje me të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistem dokumentacionin si vijon:

 [8-Katalog_veshje_pune Bajro Bros.pdf \(1,76 MB\)](#)

 [7-Autorizim Prodhuesi.pdf \(250 kB\)](#)

Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit Komisioni konstaton se, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar shprehimisht në pikën 2.4.1 të DST:.. *Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DST , operatorët ekonomikë duhet të paraqesin katalogë teknike për të gjithë mallrat furnizues, ku të jepet qartë që mallrat janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara si dhe gjithashtu nga referuar verifikimit dokumentacionit të operatorit ekonomik Bajro Bros shpk rezulton se në sistemin e prokurimit elektronik ka depozituar përkatësisht “ Katalog teknikveshje Pune Bajro Bros shpk”.*

Komisioni thekson se Ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës së prokurimit. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve apo kërkesave të tjera, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar si kriter skualifikues, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i “lex specialis”, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se përfituesi i drejtpërdrejtë i objektit të prokurimit është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 124 të LPP-së ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. 2. Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. 3. Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. 4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit. 6. Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.”*

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t'u siguruar nëse

cilësia e mallit të kërkuar në dokumentat e tenderit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Për sa më lart, Komisioni i prokurimit publik vlerëson se në kushtet kur autoriteti kontraktor ka parashikuar në pikën 2.4.1 të DST “Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DST , operatorët ekonomikë duhet të paraqesin katalogë teknike për të gjithë mallrat furnizues, ku të jepet qartë që mallrat janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara”, dhe për sa kohë operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike “*Katalog teknik*”, Komisioni gjykon se operatori ekonomik ka plotësuar kriterin e parashikuar në pikën 2.4.1 pjesë e dokumentave standarte të tenderit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.3.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ Biotek ” SHPK në lidhje” , me ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK me arsyen se, ...2.4.1 Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DST, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin katalogë teknike për të gjithë mallrat furnizues, ku të jepet qartë që mallrat janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Ndersa ne shtojcen 6 te specifikimeve teknike AK ka kerkuar:

Cizme polumbari të gjata : Duhet të jenë sipas Direktivës CE, për mbrojtjen individuale 89 /686/EEC dhe përmbush standartet evropiane EN ISO 20345 : 2011. Të jenë të certifikuar nga SATRA TECHNOLOGY INTERTE. Material sintetik dhe natyral sipas normatives EN ISO 20345 për performancë dhe cilesinë. Mbrojtja nga impakti goditës deri në 200 Joules , rezistenca në penetrim (1100 neëtones), konduktiviteti rezistenca maximale 100 kS, antistatike rezistenca nga 1005 -1000 m\$2. Permasa: Do te percaktohen nga Autoriteti Kontraktor menjehere para fillimit te levrimit te mallit

Ne lidhje me kete specifikim kemi dyshimet tone se OE ne fjale nuk ka permushur kete kerkese per dorezimin e katalogut sipas kerkeses se AK sepse Cizmet e pelumbarit jane karakteristike per punonjesit e UKV pasi ato jane cizme qe vishen dhe jane me rripa nga siper pasi duhet te rine statike dhe te jene te gjata deri ne gjoks.Puntoret punojne ne gropa te hapura si pasoje e defkteve te ndryshme dhe niveli I ujit mund ta kaloj lartesine e kembes dhe mund te jete deri ne lartesine e gjoksit.Nga vet kerkesa e AK qe kerkon cizme pelumbari te gjata do te thote qe gjatesia e ketyre cizmeve duhet te jete minimum mbi bel.

Per kete arsye kerkojme te behet verifikimi I katalogut te operatorit Bajro Bros per kete kriter.

Pershembull po ju nisim katalogun tone qe kemi dorezuar ne kete procedure prokurimi.

Këpuçë pune

E ndertuar nga lekure sintetike. Prodhuar sipas teknologjise se injektimit ne kallep, per te eliminuar bashkimet na te cilat hyn uji. Maja e kepuces sigurohet nga nje shtrese mbrojtese. Bazamenti prej Poliuretani, me shtrese Celiku, per te evituar carrjen nga gozhdet apo

materialet e mprehta. Kundra rreshkitjes ne uje dhe vaj, rezistente ndaj acideve. Kepucet ideale per mbrojtje maksimale ne pune. Permase: Do te percaktohen nga Autoriteti Kontraktor menjehere para fillimit te levrimit te mallit.

Ne lidhje me kete specifikim kemi dyshimet tone se OE ne fjale nuk ka permushur kete kerkese ne dorezimin e katalogut sipas kerkeses se AK sepse Kepucet e Punes qe Operatori Ekonomik Bajro Bros ka paraqitur nuk I permbushin kriterin e AK qe te jene te pajisura me shtrese hekuri mbrojtese ng ate dyja anet per te evituar carjen nga materialet e mprehta. Prandaj kerkojme qe te verifikohet katalogu per kete mall objekt prokurimi.

i..].

III.3. 1 Autoriteti kontraktor në seksionin 2. “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.4.1 dhe 2.4.2 dhe në shtojcën nr. 6, të dokumentave standarte të tenderit, ka parashikuar si në vijim,

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim :

2.4.1 Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DST , operatorët ekonomikë duhet të paraqesin katalogë teknike për të gjithë mallrat furnizues, ku të jepet qartë që mallrat janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.4.2 Furnizuesi duhet që të gjitha materialet t’i shoqërojë me çertifikatën e prodhuesit ose me autorizim /deklarate nga prodhuesi , që vërteton përputhjen me specifikimet teknike të kërkuara.

Shtojca 6. “Formulari i specifikimeve teknike”

1. Cizme polumbari të gjata :

Duhet të jenë sipas Direktivës CE, për mbrojtjen individuale 89 /686 /EEC dhe përmbush standartet evropiane EN ISO 20345 : 2011. Të jenë të certifikuar nga SATRA TECHNOLOGY INTERTE. Material sintetik dhe natyral sipas normatives EN ISO 20345 për performancë dhe cilesinë. Mbrojtja nga impakti goditës deri në 200 Joules , rezistenca në penetrim (1100 neëtones), konduktiviteti rezistenca maximale 100 kS, antistatike rezistenca nga 1005 -1000 m\$2. Permase: Do te percaktohen nga Autoriteti Kontraktor menjehere para fillimit te levrimit te mallit

8. Këpucë pune

E ndertuar nga lekure sintetike. Prodhuar sipas teknologjise se injektimit ne kallep, per te eliminuar bashkimet na te cilat hyn uji. Maja e kepuces sigurohet nga nje shtrese mbrojtese. Bazamenti prej Poliuretani, me shtrese Celiku, per te evituar cartjen nga gozhdet apo materialet e mprehta. Kundra rreshkitjes ne uje dhe vaj, rezistente ndaj acideve. Kepucet ideale per mbrojtje maksimale ne pune. Permase: Do te percaktohen nga Autoriteti Kontraktor menjehere para fillimit te levrimit te mallit.

III.3.2 Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.3.3 Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.3.4. Në nenin 36 , të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.3. 5 Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre,

ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të 24 barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.3.6 Lidhur me pretendimin për artikullin Cizme polumbari të gjata ...Ne lidhje me kete specifikim kemi dyshimet tone se OE ne fjale nuk ka permushur kete kerkese per dorezimin e katalogut sipas kerkeses se AK sepse Cizmet e pelumbarit jane karakteristike per punonjesit e UKV pasi ato jane cizme qe vishen dhe jane me rripa nga siper pasi duhet te rine statike dhe te jene te gjata deri ne gjoks. Puntoret punojne ne gropa te hapura si pasoje e defkteve te ndryshme dhe niveli I ujit mund ta kaloj lartesine e kembes dhe mund te jete deri ne lartesine e gjoksit. Nga vet kerkesa e AK qe kerkon cizme pelumbari te gjata do te thote qe gjatesia e ketyre cizmeve duhet te jete minimum mbi bel.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, në rastin konkret Katalogu Teknik për mallrat furnizues, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Autoriteti kontraktor me qëllimin e vlerësimit të specifikimeve teknike të mallit objekt - prokurimi ka kërkuar në DST që operatorët ekonomikë për artikullin nr. 1 “ Cizme polumbari të gjata”... *Duhet të jenë sipas Direktivës CE, për mbrojtjen individuale 89 /686 /EEC dhe përmbush standartet evropiane EN ISO 20345 : 2011. Të jenë të certifikuar nga SATRA TECHNOLOGY INTERTE. Material sintetik dhe natyral sipas normatives EN ISO 20345 për performancë dhe cilesinë. Mbrojtja nga impakti goditës deri në 200 Joules , rezistenca në penetrim (1100 neëtones), konduktiviteti rezistenca maximale 100 kS, antistatike rezistenca nga 1005 -1000 m\$2. Permasa: Do te percaktohen nga Autoriteti Kontraktor menjehere para fillimit te levrimit te mallit.* Operatorët ekonomikë ofertues në përmbushje të specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet dokumentacionit provues (në rastin konkret katalogut teknik që do të ofertojnë) duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit të paraqitur me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që vlerësimi i parametrave të paisjes së ofertuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të kryhet në mënyrë të saktë në përputhje me parametrat e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht të realizohet me sukses kontrata objekt prokurimi.

Komisioni, me marrjen në shqyrtim të ankesës, kreu verifikimet e duhura të dokumentacionit të ofertës së “Bajro Bros” shpk e përkatësisht Katalog teknik, Komisioni konstatoi, se operatori ekonomik në dokumentin emërtuar Katalog teknik prej 10 faqe, kishte evidentuar qartë parametrat për artikullin nr. 1 “ Cizme Polumbari të gjata”, të cilët duhet të përputheshin më specifikimet teknike përcaktuar në shtojcës 6. Komisioni i Prokurimit Publik në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “ Biotek ” SHPK nuk qëndrojnë.

III.3.7 Lidhur më pretendimin e operatorit ekonomik “Biotek” shpk për operatorin ekonomik “Bajro Bross” shpk me arsyen për artikullin “*Këpuçë pune*”, në lidhje me kete specifikim kemi dyshimet tone se OE ne fjale nuk ka permbushur kete kerkese ne dorezimin e katalogut sipas kerkeses se AK sepse Kepucet e Punes qe Operatori Ekonomik “Bajro Bros”shpk ka paraqitur nuk e permbushin kriterin e AK qe te jene te pajisura me shtrese hekuri mbrojtese ng ate dyja anet per te evituar carjen nga materialet e mprehta... Autoriteti kontraktor me qëllimin e vlerësimit të specifikimeve teknike të mallit objekt - prokurimi ka kërkuar në DST që operatorët ekonomikë për artikullin nr. 8 “*Këpuçë pune*“ ...E ndertuar nga lekure sintetike. Prodhuar sipas teknologjise se injektimit ne kallep, per te eliminuar bashkimet na te cilat hyn uji. Maja e kepuces sigurohet nga nje shtrese mbrojtese. Bazamenti prej Poliuretani, me shtrese Celiku, per te evituar carrjen nga gozhdet apo materialet e mprehta. Kundra rreshkitjes ne uje dhe vaj, rezistente ndaj acideve. Kepucet ideale per mbrojtje maksimale ne pune. Permasa: Do te percaktohen nga Autoriteti Kontraktor menjehere para fillimit te levrimit te mallit. Operatorët ekonomikë ofertues në përmbushje të specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet dokumentacionit provues (në rastin konkret katalogut teknik që do të ofertojnë) duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit të paraqitur me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që vlerësimi i parametrevë të paisjes së ofertuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të kryhet në mënyrë të saktë në përputhje me parametrat e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht të realizohet me sukses kontrata objekt prokurimi.

Komisioni, me marrjen në shqyrtim të ankesës, kreu verifikimet e dokumentacionit të ofertës së operatorit ekonomik “Bajro Bross” shpk, e përkatësisht “*Katalog teknik*”, Komisioni konstatoi, se operatori ekonomik ka evidentuar parametrat për artikullin nr. 8 “*Këpuçë pune*”, të cilët përputhen më specifikimet teknike përcaktuar në shtojcën 6 të dokumentave standarte të tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “ Biotek ” SHPK nuk qëndrojnë.

III.4 Lidhur me ankesën e ardhur me nr. 1650/2025 nga operatori ekonomik “ Biotek ” SHPK, lidhur me pretendimin e [...2.3.1. *Shërbime të mëparshme të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, po pa tejkaluar vleren maksimale te percaktuar ne kete procedure, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe t’i deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuar Ne lidhje me kriterin e sipercituar dyshojme se ky operator ekonomik nuk ka dorezuar*

fatura te ngjashme me vlere 20% te fondit limit sipas kerkeses te AK. Gjithashtu kerkojme te beni verifikimet nqs ky operator ekonomik ka dorezuar fatura te ngjashme me autoritete te tjera kontraktore nese ka dorezuar vertetimin e realizimit te ketyre kontratave me autoritete te tjera kontraktore ashtu sikurse kerkohet ne piken 2.3.1 pika a , Komisioni vë re se:

III. 4. 1. Autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.1, ka parashikuar se:

2.3.1.Shërbime të mëparshme të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, po pa tejkalluar vleren maksimale te percaktuar ne kete procedure, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuar*

III.4.2. Në nenin 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat për mallrave” pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se: *4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre 25 vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara..”*

III.4.3. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të

përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme

III.4.4. KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të faturave duke nisur që nga objekti, si dhe referuar kriterit përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit: 2.3.1 *Shërbime të mëparshme të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, po pa tejkalluar vleren maksimale të përcaktuar në këtë procedurë, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë :A) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. B) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuar, Komisioni mori në shqyrtim faturat me të dhënat si më poshtë:*

Fatura me numër: 54/2023 Data: 28.12.2023, Pantofla Plastike/Pandofla verore, me vlere pa tvsh 877 500,00 ALL

Fatura me numër: 44/2024 Data: 04.09.2024 ,Këmisha verore/ Kemishe m/shk, Bluzë verore/Polo m/, Pantallona verore/ Pantallona terital ,Këpucë verore/ Kepuce Copë Kapele/ Kapele sportive Copë , Shenja dalluese (supi,krahu dhe gjoksi)/ Grada Supi/Steme Krahu/Grada Gjoksi, Rrip mesi/Rripmes,Jelekfosforeshent/Jelek,Xhaketëceremoniale/XhaketePune,Pantallonaceremoniale/PantallonPune, Këmishë ceremoniale/Kemishe m/shk, Kapele ceremoniale/Kapele uniforme, Shirita tëgërshetur/Logo & Etiketa, Këpucë uniforme/Kepuce, Doreza uniforme/Doreza, Rrip mesi,rrip krahëqafë, Xhaketë/Xhakete Pune, Pantallona dimërore/Pantallona Pune, Këmisha me mënge të gjata/Kemishe mgj ,Kravate blu e errët/Kollare e thjeshte Pulovër/Pulover jake V. Xhup/Xhupa Sintetik ,Këpucë me qafë/Kepuce ,Kapele/Kapele uniforme ,Bluzë e brendshme/T-shirt , Pelerina shiu/Pelerina shiu ,Doreza lekure/Doreza lekure, me vlere pa tvsh 913 200,00 ALL.

Fatura me numër: 56/2024 , Kuverta, Jasteke per femije , Carcafe ,Kuverta ,Jasteke per te rritur Carcafe , me vlere pa tvsh 416 667,00 ALL.

Fatura me numër: 30/2023, Data 11.09.2023, Pëlhurë macun/Pëlhurë metër linear , Profile Alumini/Profile Alumini per perde ,Aksesorë/Aksesorë metalik per perde , Pëlhurë macun/Pëlhurë , Profile Alumini/Profile Alumini per perde kilogram , Aksesorë/Aksesorë metalik per perde , Pëlhurë macun/Pëlhurë metër linear , Profile Alumini/Profile Alumini per perde kilogram , Aksesorë/Aksesorë me tatalik per perde ,Pëlhurë macun/Pëlhurë metër linear , Profile Alumini/Profile Alumini per perde , Aksesorë/Aksesorë metalik per perde ,Metrazhe per perde te trasha/ Metrazhe , Aksesorë per mbajtje/Aksesorë Ganxha per mbajtje perdeshe 12 cope/Aksesore, huma totale pa TVSH: Shuma totale e TVSH-së: Shuma totale me TVSH: Shuma totale pa TVSH: 623 450,01 ALL.

Fatura me numër: 28/2023, Data 04.09.2023 , Dysheke/Dyshek Jastek per femije/Jastek bebi ,Çarçaf femijesh/Çarçaf , Kellef jasteku per femije/Kellef jasteku ,Peshqir per femije/Peshqir bebi , Batanije/Batanije bebi ,Tabet/Tapet , Perde/Perde , Perde/Perde , Perde/Perde , Perde/Perde , Perde/Perde , Shine teke per perde/SHINA metër linear, Shuma totale pa TVSH 376 540,00 ALL

Fatura me numër: 51/2023 Data 20.12.2023, Pompa thithese dhe shtytese/POMPA UJI CILESCORE, Pompe shpine gome/POMPE UJI, Motorrsharre benzine/SHARRA DRURI ME ZINXHIR, Çadra strehimi te perkohshem/Tende kampingu, Krevat+dyshek tek/PORTATIM ME BISHT, Elektrik dore/Elektrik dore Emos , Shuma totale pa TVSH: 845 675,00 ALL ,

Fatura me numër: 18/2024, Data 17.05.2024 , Krevatë tek , Dyshekë tek , Çarçafë tek Pako , Batanije tek , Jastikë , Jorgan tek , Peshqir për sytë , Peshqir për dush , Shkopa druri për perde ,Televizor , Lavatriçe ,Hapëse rrobash plastike , Pasqyrë tualeti , Tenxhere , Tigan mesatar , Tepsi mesatare , Pjata , Pjatanca Pako , Lugë Pako , Pirun Pako , Thikë Pako , Gota uji Pako ,Filxhan Çaji , Tas sallate , Mbulesa buke pambuku , Broke uji , Freskuese ,Sobë , Shuma totale pa TVSH: 712 340,00 ALL.

Fatura me numër: 24/2023 Data 27.07.2023 Karrige per zyre statike/KARRIGE METALIKE ZYRE Raft per dosje/ETAZHER ZYRE ,Raft me celes/ETAZHER ZYRE , Tavolina/TAVOLINA MESI SUPRINE MERMERI CILESCORE , Banak per kuzhine/kuzhin metër linear ,Lavaman me nje grope (me pushim ne nje ane)/Lavapjate 1+1 Copë ,7 Rubinet/Mix lavapjate , Ekspres/Sonifer Ekspres kafe , Frigorifer I vogel/Frigorifer coneliano , Divane (me 3 vende)/Divane , Raft per dosje/ETAZHER ZYRE 3SHE , Tavoline e vogel prane divanit/TAVOLINE MESI SUPR MERM , Stola plastik per femije/Stol per femije , Krevat per femije/Krevat femijesh , Dyshek/Dyshek bebi , Jastek/Jastek , Batanije/Batanije bebi ,Set carcafe/Carcaf tek , Tapet gome (puzzle) 2mx2m/Tapet puzzle per femije , Kondicioner 18/Kondicioner coneliano AST-1818 , Kondicioner 12/Kondicioner coneliano-, Kend divani/Kende , Karrige te vogla/Karrige femijesh ardeno , Tavoline loje/Tavoline loje , Fizarmonike ndarje e ambientit te gjumit/Ndarese , Shuma totale pa TVSH: 1 076 540,00 ALL

Fatura me numër: 15/2023 Data 16.06.2023 V. Tavoline loje (forme gjysem rrethi h=44 cm)/Tavoline loje , .V. Tavoline rrethore ngrenie (diametri 80 dhe h=53)/tavoline rrethore 80 , Tavoline rrethore ngrenie (diametri 60 dhe h=53)/F.V. Tavoline rrethore ngrenie , Karrige per femije (lartesia e ndenjeses h-26cm)/Karrige pisa ,. Karrige per femije (lartesia e ndenjeses h-31cm)/Karrige femijesh model 2 , Karrige per femije (lartesia e ndenjeses h-34cm)/KARRIGE ,Govate + tavoline nderrimi/KOMPLET GOVATE CAMBIO , F.V. Krevat per femijet e kopshtit/KREVATE DRURI PER KOPESHT . Krevat per femijet e cerdhes/-KREVAT BEBE ,. Dysheke per krevatet e çerdhes/Dysheke bebe ,. Set carcafesh per krevat femijesh/Carcaf bebi ,Jastek "MEMORY"/Jastek metër linear ,. Batanije per femije/Batanie ,. Raft per vendosjen e lodrave (200 X 40 X 80 cm)/F.V. Raft per vendosjen e lodrave ,. Raft per garderobe (120X40+element vertikal)/F.V. Raft per garderobe , Kosh "PLAY-STATION" (qendrim-loje)/Kosh holiday basic , Tapet "PUZZLE" me ndarje kuadratike(60 x 60x1 cm)/Tapet i bute puzzle ,. Loder plastike lekundese per ambientet e brendeshme/Kal plastik i vogel , Jastek/ndenje per femije me ngjyra (emoji)/JASTEK FISHER , Shuma totale pa TVSH: 1 949 100,00 ALL.

Fatura me numër: 10/2021 Data: 22.07.2021 Tub Zjarrëkes Ø52, 2 pol/ Tub Hidranti 2 pol 15 bar 20m/ Tub hidranti 2 polsh me aksesore ,Tub Zjarrëkes Ø38, 1 e 1/2pol/ Zorre Hidranti me bashkues zorre , Shuma totale pa TVSH 302 540,00 ALL.

Fatura me numër: 8/2021 Data 01.07.2021, Shenja Mbiemri , Pelhure pupline e bardhe/ pelhure metër linear , per rroba/ Kosha rrobash , Gershëre per prerje rrobash/ Gershëre , Rrip Makine qepse/ Aksesore makinash , Mecik Makine qepse/ aksesore makine qepese , Pllake makine qepese/ Aksesore makinash qepese , Pllake e dhembëzuar per makine qepese/ aksesore makina qepese , Pedale per makine qepese/ Aksesore per makina qepese , Hekur per hekurose/ Hekur ,Kapsa rrobash/ Kapse rrobash , Shirit Atllasi/ Aksesore per makina qepese , Penj makine me ngjyra te

ndryshme/ Fill qepje , Meter shirit/ rrobaqepsie ,, Pelhure Doku/ Pelhure ,Pelhure Atlasi/ Astar , Llastik , Ngjites per shenjat e kostumeve ushtarake/ Aksesore per makina qepese , Rrjete jeshile/ rrjete , Mbushje fikse zjarri/ Rimbushje ,Zorre uji 50 ml/ Tub hidranti 2 polsh , Pistolete uji/ Hedhes uji , Leter murale 70x77 cm/ Leter muri 3d ,: Shuma totale pa TVSH: 623 400,00 ALL .

Komisioni vlerëson se referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor, për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE ,konkretisht fatura tatimore Komisioni, pasi kreu verifikimet rezulton se operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE faturat me të dhëna si më lart përmendur, si dhe referuar verifikimeve të kryera të dokumentacionit të faturave të ngarkuara në SPE si dhe nga verifikimi i objektit të tyre punë të ngjashme si dhe nga përlllogaritja e tyre vlerave të tyre Total pa TVSH të cdo fature, rezulton se kriteri është i përmbushur nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK.

Për sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen, për ankesën së paraqitur nga operatori ekonomik “ Bajro Bros” SHPK. në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-48924-05-26-2025, me objekt “Blerje rroba pune”, me fond limit 2,465,000.00 Lekë pa TVSH zhvilluar me datë 09-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujesjëllës Kanalizime Vlorë Sh.A
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori “Bajro Bros” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-48924-05-26-2025, me objekt “Blerje rroba pune”, me fond limit 2,465,000.00 Lekë pa TVSH zhvilluar me datë 09-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujesjëllës Kanalizime Vlorë Sh.A.
3. Të mospranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ Biotek” SHPK, për procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-48924-05-26-2025, me objekt “Blerje rroba pune”, me fond limit 2,465,000.00 Lekë pa TVSH zhvilluar me datë 09-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujesjëllës Kanalizime Vlorë Sh.A .
4. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK, sipas konstatimeve të vendimit të Komisionin e Prokurimit Publik.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit.

- 6.Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik operatori ekonomik “ Bajro Bros” SHPK.
- 7.Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare në buxhet të shtetit, të paguar nga operatori ekonomik “Biotek” SHPK.
- 8.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
- 9.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

